



Pranuar / Dorezuar Primjena/Prodato Received/Delivery	19.12.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/ISHCK	8220/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.969/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.969/2022 të datës 03.11.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me numër protokolli 112-975/1 të datës 01.11.2022 dhe Vendimit me numër protokolli Nr.112-975/2 të datës 02.11.2022 të Zëvendësues së Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "*transferim i përkohshëm*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.12.2022, mori këtë

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.969/2022 e datës 03.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.112-975/1 i datës 01.11.2022 dhe Vendimi me numër Nr.112-975/2 i datës 02.11.2022 i Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal .

III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në pozitën "*Zyrtare e Lartë për Integritim Evropiane*", në Divizionin për Integritim Evropiane, sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 03.07.2020, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsy et im

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në pozitën "Zyrtare e Lartë për Integritime Evropiane", në Divizionin për Integritime Evropiane në kuadër të Departamentit për Integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave, me date 01.11.2022 me Vendimin me numër protokoll 112-975/1 të Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, transferohet përkohësisht në pozitën "Zyrtare e Lartë për Informim", në Divizionin për Komunikim me Publikun në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm. Ndërsa me pas me date 02.11.2022 Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr Vendim me numër protokoll 112-975/2, me të cilin vendim ankuesen Iliriana Bajrami e transferuar përkohësisht në pozitën "Zyrtare e Lartë për Informim" e cakton „Zëvendësuese e Udhëheqëses së Divizionit për Komunikimin me Publikun“, duke filluar nga data 02.11.2022 deri me datën 01.12.2022.

Ankuesja kundër Vendimit me numër protokoll 112-975/1 të datës 01.11.2022 si dhe Vendimit me numër 112-975/2 të datës 02.11.2022 të Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 03.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6661/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se dy vendimet janë të kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë si dhe ligjeve tjera relevante.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.11.2022 ka proceduar kërkesën e ankueses për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ndërsa Këshilli, më datë 22.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.11.2022 me numër protokoll 6661/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit e datës 03.07.2020; Vendimit me Nr.112-975/1 të datës 01.11.2022 dhe Vendimit Nr.112-975/2 të datës 02.11.2022 të zëvendës Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; E-mail i datës 31.10.2022 nga znj.V.Ç. për ankuesen; E-mail i datës 31.10.2022 nga ankuesja drejtuar Iliriana Bajrami; Diplomë Nr.3072 e datës 26.03.2015 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me vërtetim të Noterizuar me numër LRPnr.4721/2019; Diplomë Nr.31596 e datës 21.11.2017 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me vërtetim të Noterit me numër LRP.nr.4720/2019; Përgjigje në ankesë e datës 22.11.2022 me nr.Protokoll 7304/2022, përmes emailit zyrtar të Menaxheres së personelit të MAPL-së; Përshkrimi i detyrave të punës 28.10.2018; E-mail i datës 21.11.2022 nga Menaxheres së personelit të MAPL-së, për znj.E.B; E-mail i datës 31.10.2022 nga Shkrimorja e MAPL-së për ankuesen; E-mail i datës 01.11.2022 nga znj.V.Ç. për ankuesen; Email i datë 1.11.2022 nga ankuesja për znj.V.Ç.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e bazuar sepse:

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimit të datës 03.07.2020 ka konstatuar se ankuesja, Iliriana Bajrami është e punësuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 03.07.2020 në pozitën "Zyrtare e Lartë për Integritim Evropiane", në Divizionin për Integritim Evropiane në kuadër të Departamentit për Integritim Evropiane dhe Koordinim të Politikave, ndërsa e njëjta me Vendimin me numër protokollit 112-975/1 të datës 01.11.2022 të Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, është transferuar përkohësisht data 01.11.2022 deri me datën 31.01.2023 në pozitën "Zyrtare e Lartë për Informim", në Divizionin për Komunikim me Publikun në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm. Ndërsa me pas me datën 02.11.2022 Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr Vendim me numër protokollit 112-975/2, me të cilin vendim ankuesen e transferuar përkohësisht në pozitën "Zyrtare e Lartë për Informim" e cakton „Udhëheqëses së Divizionit për Komunikimin me Publik, duke filluar nga data 02.11.2022 deri me datën 01.12.2022, me arsyetimin e mbarëvajtjes së punës dhe në funksion të koordinimit dhe kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi në këtë divizion pasi që pozita e udhëheqësit është e lire.

Ankuesja në ankesën e saj të parashtruar me datën 03.11.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, pretendon se organi i punësimit me rastin e transferimit të përkohshëm të saj dhe caktimit në pozitën e zëvendësueses ka vendosur në mënyrë të gabuar dhe jo të drejtë duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë si dhe ligjeve tjera relevante.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 2 paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale, dhe nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku është përcaktuar se: "Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet", dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson se organi i punësimit ka të drejtë që nëpunësin civil ta transferojë përkohësisht për interes të institucionit, mirëpo në kuptim të nenit 52 paragrafi 7 të të njëjtit ligj, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Kolegji konstaton se transferimi i përkohshëm në interes të institucionit është në kompetencë të njësisë përgjegjëse.*

Sipas dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, njësia përgjegjëse në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal është Njësia për Burime Njerëzore. Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse në rastet e tilla njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet, dhe se për marrjen e këtij vendimi njësia

përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se vendimi për transferimin e ankueses nga pozita e punës *Zyrtare e Lartë për Integritet Evropian*, në pozitën e punës *„Zyrtare e Lartë për Informim“* nuk është miratuar nga organi kompetent, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, dhe rrjedhimisht nga organi i punësimit nuk është dhënë asnjë arsyetim në lidhje me marrjen e kompetencës së njësisë përgjegjëse nga udhëheqësi me i lartë administrativ. Andaj bazuar në këtë konstatim, Kolegji i Këshillit vlerëson se akti i kontestuar respektivisht Vendimi me numër protokollit 112-975/1 i datës 01.11.2022 është nxjerr nga organi jo kompetent dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga provat e lëndës po ashtu ka konstatuar se Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, vendimin me numër protokollit 112-975/1 të datës 01.11.2022, për transferimin e përkohshëm të ankueses nga pozita e punës *Zyrtare e Lartë për Integritet Evropian*, në pozitën e punës *„Zyrtare e Lartë për Informim“* e ka nxjerr në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *“1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori”* si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, i cili përcakton se, *8. Përshkrimi i përgjithshëm i punës për kategorinë Profesionale 1. Kategoria Profesionale është kategoria përgjegjëse për zbatimin e detyrave në përputhje me dispozitat ligjore, udhëzimet dhe procedurat e cila ofron mbështetje profesionale dhe administrative, pa u përfshirë në përgjegjësi mbikëqyrëse. 2. Veprimtaria e përditshme kërkon njohuri të përgjithshme profesionale dhe administrative dhe/ose njohuri të posaçme të një profesioni të caktuar”*, sepse edhe përkundër faktit që në pajtim me dispozitën e nenit 52 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë thuhet në mënyrë të përgjithësuar se *„Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, njësia përgjegjëse është e obliguar që në zbatimin e kësaj dispozite të marrë parasysh të gjitha specifikat e pozitës së lirë dhe plotësimin e kushteve ligjore të nëpunësit që transferohet respektivisht në rastin konkret me rastin e transferimit të ankuesit kanë qene të obliguar që të marrë parasysh kualifikimet dhe përgatitjen e ankueses në raport me përshkrimin e detyrave të punës dhe kërkesat specifike të vendit të punës ku është transferuar nëpunësja.*

Ndërsa lidhur me pretendimet e ankueses për caktimin Zëvendësuese të pozitës *Udhëheqëse e Divizionit për Komunikimin me Publikun*, Kolegji, konstaton se caktimi i ankueses si zëvendësuese është bërë si pasojë e transferimit të përkohshëm, gjegjësisht sipas Vendimit me numër protokollit 112-975/1 të datës 01.11.2022, i cili si më lartë është vlerësuar që është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin nën fuqi, rrjedhimisht edhe caktimi i ankueses si Zëvendësuese e *Udhëheqëses së Divizionit për Komunikimin me Publikun*, është bërë në mënyrë të kundërligjshme, sepse ankuesja nuk është pjesë e Divizionit për Komunikim me Publikun për tu caktuar edhe zëvendësuese ashtu siç parashihet me nenin 20 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, sepse zëvendësimi në rastet e tilla bëhet vetëm kur nëpunësi civil që ushton pozitën permanente gjendet p.sh gjendet në pushim vjetor, pushim

mjekësor, vizitë jashtë vendi. Ndërsa dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të nëpunësit civil të përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të bëhet për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla duhet të behët vetëm përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses sa i përket pretendimit ankimor se Vendimi me numër protokolli 112-975/1 i datës 01.11.2022 dhe Vendimi më numër protokolli 112-975/2 i datës 02.11.2022 të Zëvendësueses së Sekretares së Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton përveç konstatimeve si më lartë, vendimet e kontestuar me ankesë nuk përmbajnë të gjitha elementet e aktit administrativ konkretisht nuk përmbajnë saktë pjesën urdhëruese (dispozitivin), nuk përmban pjesën arsyetuese dhe nuk përmban këshillën juridike, siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë"*, dhe pretendimet e ankueses janë të bazuara.

Andaj, bazuar si më lartë dhe në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nga organi që nuk ka kompetencë, dhe me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Kolegji, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke u bazuar me nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi për aprovimin e ankesës dhe rrjedhimisht shfuqizimin e dy akteve administrative të kontestuar, duke detyruar njëkohësisht organin e punësimit që ankuesen ta kthej në pozitën e saj sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 03.07.2020, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.969/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

MALSORE GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.